

Për nevojat e shërbimeve kontabiliste-financiare, gjegjësisht kontabilistëve, kontabilistëve të autorizuar ose zyrat e kontabilitetit të cilat kryejnë punë financiare-kontabiliste të shoqatave të pensionistëve, Lidhja përgatiti dhe material të veçantë profesional "Doracak për përpilim të raporteve financiare dhe llogarisë vjetore të shoqatave të pensionistëve dhe LSHPM për vitin afarist 2019"

AKTIVITETET E LSHPM

PREZANTOHET DORACAK PËR PËRPILIM TË RAPORTEVE FINANCIARE PËR PENSIONISTËT



Lidhja përgatiti dhe material të veçantë profesional "Doracak për përpilim të raporteve financiare dhe llogarisë vjetore të shoqatave të pensionistëve dhe LSHPM për vitin afarist 2019". Autor i doracakut është Romeo Kostadinov, ekonomist i diplomuar, ndërsa recensues është ekonomisti i diplomuar Mitre Stojanovski, subjekt profesional nga fusha e financave dhe kontabilitetit, kryetar i Bordit mbikëqyrës në LSHPM, i cili theksoi që materiali në Udhëzuesin është i përgatitur në mënyrë profesionale në pajtim me Ligjin dhe Rregulloren për kontabilitet të organizatave jofitimprurëse. Autori i doracakut, Romeo Kostadinov, ceku çështjet më të rëndësishme në lidhje me përgatitjen e raporteve financiare dhe llogarisë vjetore për vitin 2019 me shembuj adekuat. Kostadinov iu referua edhe ndryshimeve në Ligjin e tatimit të fitimit. Prezantimi i tij ishte i përcjellë me video shtojca. Pastaj kishte debat të pasur me pyetje nga pjesëmarrësit e pranishëm të punëtorisë të cilave recensuesi Stojanovski dhe autori Kostadinov dhanë përgjigje shteruese.

M. Stojanovski

LSHPM në pajtim me Programin për punë edhe këtë vit më 3 shkurt të këtij viti, në restorantin "Brod Panini" -Veles, në Liqenin Mladost, organizoi Punëtori për përgatitje më të mirë të punëtorisë financiare dhe llogaricë vjetore për vitin 2019. Në punëtorinë morën pjesë kryetarja e LSHPM, Stanka Trajkova, kryetari i Kuvendit të LSHPM, M-r Ilija Adamoski dhe nënkryetari dhe sekretari i KE të LSHPM, Mentor Qoku dhe Menka Tremelkovska. Krahas udhëheqësisë së Lidhjes, të 87 të pranishmëve nga 30 shoqatat e pensionistëve, me prezencën e tij u bëri nderë drejtori gjeneral i FSPIM, Shaip Zeneli, si dhe drejtori gjeneral M-r Hristo Kondov-


ski dhe drejtori i shitjes Bojan Moskov nga kompania CH Broker sigurime SHA Manastir.

Në fillim të punëtorisë, fjalën e mori kryetarja e LSHPM, Stanka Trajkova, e cila i përshëndeti të pranishmit dhe mysafirët dhe e potencoi dobinë e kësaj këshillmore tradicionale të tetë me radhë, e cila kësaj radhe ishte e pasuruar edhe me informacione të tjera të dobishme dhe të rëndësishme. Pastaj të pranishmëve iu drejtua M-r Hristo Kondovski, drejtor i CH Broker sigurimi SHA Manastir, kompani me të cilën para disa kohe u lidh marrëveshje trepalëshe për bashkëpunim biznesi me LSHPM dhe Fondin për SPIM. Në emër të Fondit për sigurim pen-

sional dhe invalidor të RMV, para të pranishmëve, foli drejtori gjeneral i Fondit Shaip Zeneli.

Pasi që kryetarja e LSHPM Trajkova ju falënderua mysafirëve për informacionet e dobishme të dhëna dhe për prezencën, filloi punëtorinë për avancim të punës së shoqatave të pensionistëve për punën e tyre të kontabilitetit në temën: "Përpilimi i raporteve financiare dhe llogarisë vjetore për vitin 2019 të shoqatave të pensionistëve dhe Lidhjes. Për nevojat e shërbimeve kontabiliste-financiare, gjegjësisht kontabilistëve, kontabilistëve të autorizuar ose zyrat e kontabilitetit të cilat kryejnë punë financiare-kontabiliste të shoqatave të pensionistëve

TETOVARI FEJZI RUSTEMI



Kampion në domino mes pensionistëve

Në mesin pensionistëve, të cilët garojnë në domino, emri i pensionistit tetovar Fejzi Rustemi tashmë është i njohur. Nga pensionimi i tij, në vitin 2013, deri më sot, vazhdimisht është në garat rajonale, ku e merr vendin e parë dhe merr diplomë, me çka e fiton të drejtën në pjesëmarrje në garat republikane. Edhe aty, mes më të mirëve nga të gjitha rajonet e vendit, Rustemi tashmë i radhit sukseset, ka të fituar vende të para dhe medalje të arta në vitin 2014 dhe 2017, ndërsa në të tjerat, deri në vitin e kaluar, e ka fituar vendin e tretë. "Gjithmonë kur kam kohë, ndërsa si pensionist kam mjaft kohë në dispozicion, jam mes dashamirëve të dominosë. Kjo lojë do ushtrime të vazhdueshme, të jesh i shkathët, të dish ta "neutralizosh" atë që e ke provokuar dhe në fund, fati të të shërbejë. Nuk është e gjitha "filozofi" ta vendosësh "gurin" në paralelë, por ta pengosh atë nga ana tjetër, të mundësosh i pari të lirohet nga dominot "e blera". Unë mendohem të jem racional dhe mendoj që arrij sukses", na tha Fejzi Rustemi. Ky pensionist dhe lojtar i palodhshëm në domino, thotë që shpesh është në klubin e pensionistëve në Tetovë, ku shpesh e ka provuar fatin dhe shkathësinë edhe në luajtjen tablo. Por, në atë nuk mund të lavdërohet, e as nuk është paraqitur në këtë disiplinë. Për atë shkak, në domino, ai thotë se do të luajë përderisa është duke fituar, ndërsa pastaj do ta liroj vendin për më të rinjtë dhe më të shkathët se ai vet. Fejzi Rustemi është anëtar i organit rajonal të pensionistëve "Teteks" në Tetovë. "Aty jam anëtar dhe më mjafton që jam në takimet kur thirren dhe mbledhen pensionistët nga rajoni i tyre", është shprehur Rustemi. Fejzi Rustemi është nga vendi i quajtur "Çarshia tetovare", për shkak që kohën e punës e ka kaluar në ndërmarrjen tregtare të njohur "Interpromet", prej ku në vitin 2013 e ka marrë të drejtën e pensionit. G. Eftoski

SHP TETOVË

Ndahen 120 pako për solidaritet

Shoqata e pensionistëve Tetovë gjatë muajit janar ose të ashtuquajturin "Muaji i festave dhe shpenzimeve", shpërndau 120 pako për solidaritet me artikuj ushqimor dhe me pjesë të mjeteve për higjienë personale pensionistëve anëtarë të shoqatës me të ardhura të ulëta ose të sëmurë dhe në gjendje të vështirë. Duke e pasur parasysh numrin e madh të festave, e me atë edhe shpenzimeve të rritura në familjet e pensionistëve, Shoqata e pensionistëve Tetovë me pjesë të mjeteve të planifikuara për "Ndihma për pensionistët" ndau 120.000 denarë për furnizim të 120 pakove për solidaritet. Për këtë aktivitet, me kohë u njoftuan të gjithë degët, me qëllim që këshillat e degëve të përpilojnë lista të pensionistëve nga kategoria e të prekurve materialisht dhe të njëjtëve t'u ndihmohet dhe lehtësohet në këtë mënyrë gjendja e tyre e rëndë materiale. Me këtë aktivitet u përfshinë të gjitha degët dhe ndihma u shpërndau në mënyrë të barabartë për secilën degë sipas madhësisë dhe numri të pensionistëve të cilëve u duhet ndihma. Efekti nga ky aktivitet, mund të lexohet nga fytyrat e pensionistëve të cilët vinin në Shoqatë që t'i marrin pakot dhe shfaqën falënderime nga ana e tyre për ndihmën dhe kujdesin e marrë. Ky aktivitet në Shoqatën e pensionistëve Tetovë sipas mjeteve të planifikuara me planin financiar për vitin 2020, do të vazhdojë edhe në periudhën e ardhshme në forma të ndryshme të ndihmës së pensionistëve siç janë ndarja e ndihmës së njëhershme në të holla, sipas Vendimit ekzistues me kritere, pako solidarite, organizim të ekskursioneve pa pagesë për pensionistët me të ardhura të ulëta dhe forma të tjera të ndarjes së ndihmës. Svezozar Dimovski

SHP KUMANOVË

Klub i ri në degën "B.S.GOJÇO"

Më 31 janar të këtij viti ishte hapja e klubit të ri në degën "B.S.GOJÇO" pranë SHP Kumanovë. Gjatë futjes brenda na pritën pensionistët dhe kryetari i degës "B.S.GOJÇO"- Dragi Stefanovski, të gjithë të emocionuar sepse nuk hapet çdo ditë klub i ri. Në hapje të pranishëm ishin Kryetari i SHP Kumanovë, Blage Jakimovski, nënkryetari Gjorgji Lititarov dhe sekretari i shoqatës Gordica Boshkovska. Në hapjen e klubit me prezencën e tyre pensionistët kumanovarë i nderoi edhe kryetarja e LSHPM, Stanka Trajkova. I pari me fjalim rasti të pranishmëve iu drejtua kryetari i SHP, Blage Jakimovski. "Ky klub është i hapur si i gjashti me radhë. Bëjmë përpjekje me vetëqeverisjen lokale të na sigurojnë hapësira ku do të hapen qendra për qëndrim ditor për pensionistët tanë, aty ku do të shqërohen dhe do kalojnë momente të

bukura", u shpreh Jakimovski. Pensionistëve të pranishëm iu drejtua dhe i përshëndeti kryetarja e LSHPM Stanka Trajkova. "Hapja e klubit të ri ka rëndësi të madhe për shoqatën për arsye që klubet e pensionistëve janë në kate ku me të vërtetë ndihet pulsi i jetës pensioniste. SHP Kumanovë ka diku 15902 pensionistë, që do të thotë që është një nga shoqatat më të mëdha. Ndjej kënaqësi që punon me rezultate që shihen. Uroj edhe më tej të hapen klube si ky. Në këto klube do të tregohen shumë përralla dhe fate. Këtu shërohen të sëmurit dhe shërohet dhimbja më e madhe - vetmia", është shprehur Trajkova. Fjalimet e kryetarit të SHP Kumanovë Blage Jakimovski dhe kryetares së LSHPM Stanka Trajkova u dëgjuan nga ana e pensionistëve kumanovarë me kujdes të madh dhe u duartkrokitën. Triçkovic Liljana.

